L I G J
Nr.8094, datë 21.3.1996

PËR LARGIMIN PUBLIK TË MBETURINAVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj synon mbrojtjen e mjedisit urban nga ndotja me mbeturina, si dhe largimin publik të tyre në brendësi të territoreve bashkiake e të komunave, sipas vijave kufizuese që janë në juridiksionin e çdo bashkie e komune.

Ai synon gjithashtu disiplinimin e shërbimeve publike për pastrimin e mbeturinave të qyteteve (dorëzimin, mbledhjen, fshirjen dhe grumbullimin) brenda perimetrit të territoreve të mësipërme.

Neni 2
Pronësia

Të gjitha llojet e mbeturinave, sipas përcaktimit të bërë në këtë ligj, pas dorëzimit të tyre janë pronë shtetërore.

Neni 3
Parime të përgjithshme

Shërbimi i pastrimit të mbeturinave respekton këto parime të përgjithshme:

1. Mënjanimin e çdo dëmi a rreziku për shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e jetës së personit.
2. Garantimin e kërkesave higjieniko-shëndetësore dhe çdo rrezik ndaj ndotjes së ajrit, ujit, tokës e nëntokës.
3. Të ruajë e të mbrojë faunën e florën dhe degradimin e mjedisit e të peizazhit.

Neni 4
Përkufizime

Sipas këtij ligji termat vijues kuptohen si vijon:

1. "Mbeturina" janë lëndët ose objektet që dalin nga veprimtaria njerëzore ose ciklet natyrore të destinuara për braktisje.
2. "Largimi publik i mbeturinave" quhet procesi i dorëzimit, mbledhjes, transportimit dhe grumbullimit të mbeturinave.
3. "Grumbullimi i mbeturinave" quhet procesi i pranimit të mbetjeve në vende të caktuara.
4. "Vendi i grumbullimit" të mbeturinave është sipërfaqe toke e caktuar nga pushteti lokal për përpunimet dhe manipulimet që do të realizohen.
5. "Objekt i vëllimshëm" quhen objektet e mëdha të mbetjeve të ngurta, si pajisje, mobilie, pjesë autoveturash, penobetone, metale dhe mbeturina të tjera të vëllimshme, përmasat e të cilave pengojnë përdorimin e metodave të zakonshme të mbledhjes, transferimit ose hedhjes së tyre.
6. "Konsumatori" quhet një njësi komerciale, industriale a institucionale, ose një person që zotëron, merr me qira, jep me qira ose mban a përdor një apartament në mënyrë tjetër, që ndodhet

brenda qytetit e mund të përdorë shërbimet e kontenierëve dhe ku shërbimi i mbledhjes së plehrave sigurohet nga kontraktuesi.

7. “Edukimi publik” quhet përpjekja për të rritur a përmirësuar njohuritë e konsumatorëve, të kontraktuesit a banorëve të qytetit në lidhje me largimin e plehrave, mbledhjen dhe hedhjen ose çdo aspekt tjetër të administrimit të tyre.

8. “Zonë e kontratës” quhet zona brenda kufijve të vijës së verdhë, ku kontraktuesi do të sigurojë shërbimin e administrimit të plehrave ndaj konsumatorëve ekzistues, si dhe gjithë konsumatorët që mund të shtohen gjatë kohështrirjes së kontratës brenda së njëjtës zonë. Kufijtë e zonës së kontratës përcaktohen nga bashkia ose komuna.

9. “Rrugë” është një zonë e shtruar midis vijave kufizuese.

10. “Zonë e lagies” quhet shërbimi i lagies së rrugëve, pa trotuaret e rrugëve.

11. “Dorëzimi” quhet nxjerrja dhe hedhja e mbeturinave nga prodhuesit e tyre në vendet e mbledhjes së mbeturinave.

12. “Mbeturina të rrezikshme” quhen mbeturinat e dëmshme a toksike, që rrezikojnë shëndetin e personit dhe sjellin pasoja ekologjike.

13. “Mbeturina të papranueshme”, në kuptimin e këtij ligji, janë mbeturinat e rrezikshme a të vëllimshme, të cilat administrohen me ligje të veçanta.

KREU II

Neni 5
Mbeturinat

Mbeturinat, në kuptimin e këtij ligji, janë lëndët ose objektet që dalin nga veprimtaritë njerëzore, ekonomi shtëpiake të braktisura a që janë të destinuara për braktisje.

Në kuptim të këtij ligji me emërtimin “mbeturina” përfshihen:

a) Papastërtitë që dalin nga shtëpitë e banimit, mbeturinat e kuzhinës, rrecka, cifla, kanoçe, hi, blozë, plastike etj.

b) Papastërtitë që dalin nga lokalet.

c) Papastërtitë që dalin nga kopshtet, lulishtet dhe oborret funksionale të ndërtesave publike (lokale, restorante) etj.

ç) Papastërtitë që dalin nga ndërmarrjet private e shtetërore, të shkaktuara nga prodhimi, si ai artizanal, tregtar, i shërbimeve etj.

d) Papastërtitë që dalin nga ndërtimet e ndryshme, si rëra, dhera etj., që janë në masa të parëndësishme sa 1/10 m3.

Neni 6
Përjashtime

Nuk quhen mbeturina në kuptimin e këtij ligji dhe nuk përfshihen në largimin publik të mbeturinave:

1. Mbetjet radioaktive.

2. Mbetjet nga puna kërkimore, industria nxjerrëse e përpunuese e trajtimit dhe e grumbullimit të pasurive minerare të shfrytëzimit të vendburimeve të ndryshme.

3. Toka, balta, bora, akulli, fekalet, mbeturinat që vijnë nga lëndë të shuara ose të nxehta.

4. Mbeturina zanati, papastërtitë e stallave, kadavrat, lëngjet, mbetjet e vajrave lubrifikante e të benzinës.

5. Lëngjet eksplozive, substancat gërryese, mbetjet e ngjyrave e të karbiteve.

6. Ngordhësirat.

7. Mbetjet bujqësore.

8. Lëndët shpërthyese dhe eksplozive.

9. Materialet fekale.

10. Mbetjet nga ndërtimet dhe meremetimet e objekteve e të veprave me përmasa mbi 1/10 m3.

11. Lëndët materiale të tjera që ndodhen jashtë vijës kufizuese të qyteteve a komunave, si dhe

lëndë e materiale të tjera që parashikohen e disiplinohen me ligje të veçanta.

12. Mbeturinat e tjera të çdo lloji që gjatë largimit të tyre shkaktojnë dëmtime dhe mund të vënë në rrezik organizma që merren me largimin e tyre, nxjerrin në ajër lëndë të ndryshme, sjellin shkatërrime etj.

13. Klasifikimi dhe përcaktimi konkret i mbeturinave dhe i natyrës së tyre do të bëhet në rregulloren e shërbimit të pastrimit.

Neni 7

Dorëzimi i mbeturinave

Nxjerrja dhe dorëzimi i mbeturinave bëhet nën kujdesin dhe përgjegjësinë e prodhuesit të mbeturinave.

Prodhuesi i mbeturinave detyrohet të mbështjellë dhe mbulojë mbeturinat, për të mënjanuar çdo rrezik për përhapjen e tyre.

Dorëzimi i mbeturinave kryhet nëpërmjet koshave, kazanëve e stacioneve të betonit në pika të caktuara të vendosura nga bashkia e qytetit dhe komuna.

Neni 8

Mbledhja e mbeturinave

Mbledhja e mbeturinave dhe largimi i tyre për në vendgrumbullim bëhet nga personat fizikë e juridikë që janë të specializuar e licencuar në shërbimet e pastrimit të mbeturinave.

Neni 9

Metodat dhe teknologjitë që përdoren ose do të përdoren për largimin publik të mbeturinave, caktohen nga bashkitë dhe komunat, në bashkëpunim me organet kompetente, sipas rregullores për shërbimin e pastrimit publik.

Neni 10

Transportimi i mbeturinave

Shërbimi i transportit të mbeturinave kryhet me mjete që sigurojnë respektimin e kërkesave higjeniko-shëndetësore dhe ekologjike e që respektojnë normat e qarkullimit, duke qenë të pajisura me leje (autorizim) për kalime në rrugë të ndaluara për qarkullimin dhe për qëndrime në vendet e ndalimqarkullimit.

Neni 11

Ndalime e kufizime

Ndalohet ndryshimi arbitrar i vendgrumbullimeve të plehrave (mbeturinave), i kontenierëve, i pikave të koshave dhe stacioneve të betonuara për hedhjen dhe dorëzimin e mbeturinave.

Ndalohet ndryshimi i cilësisë së truallit, i vendosjes së këtyre pikave, i metodave të teknikës dhe teknologjisë së mbledhjes së mbeturinave e të transportimit të tyre, në kundërshtim me atë që është përcaktuar në kontratën e lidhur. Çdo ndryshim i parashikuar në paragrafët e mësipërm, bëhet me miratim me shkrim të organeve të pushtetit lokal, duke mbajtur parasysh kushtet tekniko-higjienike dhe të mjedisit.

Neni 12

Çdo mbeturinë, sipas përcaktimeve të bëra me këtë ligj, duhet të hidhet vetëm në kontenierët e caktuar për largimin publik të mbeturinave.

Kontenierët lejohet të përdoren vetëm për hedhjen dhe dorëzimin e mbeturinave. Mbeturinat e përcaktuara në nenin 5 “e” nuk lejohet të zënë më shumë se 1/4 e vëllimit të një kontenieri.

Zbrazja ose kërkimi në kontenier bëhet vetëm nga personat e autorizuar nga sipërmarrësi.

Ndalohet hedhja e mbeturinave jashtë kontenierëve.

Neni 13
Përpunimi i mbeturinave

Trajtimi i mbeturinave bëhet me ligje të veçanta.

Neni 14
Kontrolli dhe mbikëqyrja

Bashkia e qytetit dhe komuna kanë të drejtë të kontrollojnë e mbikëqyrin për zbatimin e largimit të mbeturinave, në përputhje me kushtet tekniko-higjienike, në zbatim të kontratës, nga personat e autorizuar prej saj.

Neni 15
Prodhuesit e mbeturinave

Të gjithë personat fizikë e juridikë, familjet, pronarët e dyqaneve, të lokaleve, objekteve të ndryshme, që prodhojnë mbeturina dhe përfshihen në largimin publik të mbeturinave, sipas dispozitave të këtij ligji detyrohen të lejojnë largimin e mbeturinave.

Neni 16
Të drejtat dhe detyrat

Të gjithë personat fizikë e juridikë kanë për detyrë të mbrojnë mjedisin urban nga ndotja e mbeturinave në të gjitha mjediset publike e private, në hapësirat e zbuluara (që nuk përfshihen nga shërbimi i pastrimit), si dhe përreth territorit të tyre.

KREU III
ZONAT E PASTRIMIT

Neni 17
Zonë pastrimi

Bashkitë e qyteteve dhe komunat, brenda perimetrit të vijës kufizuese që ato kanë nën juridiksion, bëjnë ndarjen territoriale në zona pastrimi, së bashku me seksionin e urbanistikës, si më poshtë:

1. Qytetet me popullsi deri në 100 000 banorë kanë një zonë pastrimi.
2. Qytetet me popullsi mbi 100 000 banorë mund të organizojnë disa zona pastrimi.

Neni 18
Lagia e zonave të pastrimit

Lagia e zonave të pastrimit quhet shërbimi i lagies së rrugëve. Zona e lagies së rrugëve përfshihet në kontratë, duke përfshirë edhe vendet publike që administrohen nga bashkia.

KREU IV
LARGIMI PUBLIK I MBETURINAVE

Neni 19
Largimi i mbeturinave

Largimi publik i mbeturinave (pastrimi) është mbledhja me kontenier dhe transportimi i tyre në vendet e caktuara nga bashkia e qytetit ose komuna.

Mbledhja dhe transportimi i mbeturinave bëhet në përputhje me rregullat teknike të higjienës

dhe të depozitimit të tyre, të përcaktuara në rregulloren e pastrimit të qyteteve.

Neni 20

Largimin publik të mbeturinave e organizojnë organet e pushtetit lokal, në zbatim të procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Për çdo zonë pastrimi organet e pushtetit lokal lidhin kontratë me sipërmarrësit e këtyre shërbimeve me afate deri në 5 vjet, sipas dispozitave në fuqi të prokurimit publik.

Neni 21

Mbledhja dhe largimi i mbeturinave kryhet nga persona fizikë e juridikë, publikë e privatë, që janë të specializuar në shërbimet e pastrimit dhe grumbullimin e mbeturinave. Në zonat e banimit që janë jashtë vijave kufizuese të bashkive e komunave, largimi publik i mbeturinave bëhet me akte nënligjore.

Neni 22

Organet e pushtetit lokal (bashkia, komuna) caktojnë një person për kontrollin e zbatimit të kontratës (mbikëqyrës), i cili paguhet nga taksat e mbledhura për shërbimin e pastrimit.

Neni 23

Kushtet e garës

Për largimin publik të mbeturinave, për çdo zonë, bashkia e qytetit dhe komuna, organizojnë prokurimin, duke pasur parasysh:

1. Të dhënat për zonën e pastrimit.
2. Planimetrinë e zonës së pastrimit.
3. Llojet e mbeturinave që janë objekt i kontratës dhe përjashtimet.
4. Afatet e kontratës.
5. Frekuencën e shërbimit.
6. Grafikun e lagies së rrugëve.
7. Vendgrumbullimin e plehrave.
8. Masën e edukimit publik e shëndetësor.
9. Teknologjinë e mbledhjes e të largimit të mbeturinave.
10. Dokumente të tjera të nevojshme për prokurim, në bazë të dispozitave ligjore.

Neni 24

Përfshin

Largimi publik i mbeturinave përfshin:

1. Dorëzimin e mbeturinave.
2. Mbledhjen e mbeturinave.
3. Pastrimin dhe grumbullimin e mbeturinave të rrugëve.
4. Transportimin e mbeturinave.
5. Menazhimin dhe vendgrumbullimin e mbeturinave.
6. Lagien e rrugëve.

Në largimin publik të mbeturinave, sipas dispozitave të këtij ligji, përfshihen:

a) Gjithë personat fizikë e juridikë që shkaktojnë mbeturina sipas përcaktimit të bërë në nenin 4, organet lokale dhe institucionet qendrore, organizatat shoqërore, fetare etj.

b) Të gjitha familjet me banim të përhershëm në një qytet a komunë të caktuar.

c) Të gjithë personat fizikë e juridikë ose persona të ndryshëm që ushtrojnë veprimtari të përkohshme në qytete mbi 3 muaj.

Neni 25

Vendgrumbullimi i mbeturinave publike, për bashkitë e qytetit dhe komunat, është gjithnjë jashtë perimetrit të vijës kufizuese të tyre.

Neni 26
Situata të jashtëzakonshme

Në rastet e situatave të jashtëzakonshme që lidhen me forca madhore, me shëndetin publik ose mjedisin, organet e pushtetit lokal, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, me shërbimin higjieniko-shëndetësor, nxjerrin urdhër për masat e veçanta që duhen zbatuar gjatë vazhdimit të situatës së jashtëzakonshme.

Ato kanë të drejtë të shpallin ndalimqarkullimi të përgjithshëm për mjete të veçanta të përkohshme.

KREU V
PASTRIMI I HAPËSIRAVE TË ZBULUARA

Neni 27
Hapësira të zbuluara

Vendet e zbuluara të hapësirave private në brendësi të ndërtimeve, që janë në përdorim të përbashkët (bashkëpronësi) dhe në përdorim të veçantë (pronë private), të rrethuara ose jo, janë nën kujdesin e pronarëve të tyre.

Pronarët e këtyre hapësirave detyrohen të ndalojnë ndotjen dhe të mirëmbajnë këto mjedise, duke larguar në çdo mënyrë mbeturinat.

Neni 28
Terrenet publike dhe private

Terrenet publike ose private, që nuk janë të zëna me ndërtime, detyrimisht duhet të jenë të lira nga ndotjet dhe mbeturinat, sipas përcaktimit në këtë ligj, nga institucionet përkatëse ose pronarët e këtyre territoreve.

Neni 29
Ndërtimet e reja

Në të gjitha ndërtimet e reja, publike a private, që realizohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, detyrohen të parashikojnë hapësira të posaçme, pranë rrugëve publike, për vendosjen e kontenierëve, kazanëve, koshave, si pikë për dorëzimin e mbeturinave.

Këto pika për dorëzimin e mbeturinave miratohen së bashku me projektin dhe planin urbanistik.

Neni 30

Gjithë personat fizikë dhe juridikë që kryejnë veprimtari stacionare ose ambulatore dhe ata që kryejnë veprimtari transporti (ngarkim-shkarkim), detyrohen të mbajnë pastër truallin përreth lokalit dhe vendit të punës në një gjerësi 2-5m.

KREU VI
TARIFAT

Neni 31
Caktimi i tarifave

Bashkitë dhe komunat caktojnë tarifat për largimin publik të mbeturinave. Tarifat e pastrimit caktohen duke pasur parasysh teknikën dhe teknologjinë e përdorur, koston, numrin e kontenierëve dhe kushte të tjera.

Neni 32
Pagimi i taksave

Pagesa e taksës së pastrimit është e detyrueshme dhe e menjëhershme për gjithë personat fizikë e juridikë që përfshihen në largimin publik të mbeturinave, sipas përcaktimit të bërë në nenin 24 të këtij ligji.

Pagesa vjetore e taksës së pastrimit ndahet me këste mujore.

Neni 33
Financimi

Shpenzimet për largimin publik të mbeturinave dhe shpenzimet e tjera që përdoren për këtë qëllim, mbulohen nga taksat e mbledhura për kryerjen e shërbimit të pastrimit dhe pjesërisht nga buxheti i shtetit në raporte që do të vendosen nga qeveria.

Neni 34
Mbledhja e taksës

Mbledhja e taksës për pastrimin bëhet nga personat e autorizuar nga bashkia dhe komunat.

KREU VII
SANKSIONE

Neni 35

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, parashikuar në nenin 2, dënohen me gjobë deri në 5000 lekë.

Neni 36

Shkelja e dispozitave të këtij ligji parashikuar në nenet 3, 9, 10 dhe 21, gjatë kryerjes së veprimtarisë për largimin publik të mbeturinave, nga personat fizikë dhe juridikë, vendas a të huaj, dënohet me gjobë deri në 100 000 lekë.

Në raste përsëritjeje, anulohet leja (licenca) për ushtrim veprimtarie nga organi që e ka lëshuar atë.

Neni 37

Shkelja e dispozitave të këtij ligji, parashikuar në nenet 7, 11, 14, 15, 23, 24 dhe 27, keqpërdorimi, ndërrimi i destinacionit të kazanëve, koshave, stacioneve të betonuara të plehrave, hedhja e parregullt e plehrave dhe atyre voluminoze, hedhja e mbeturinave të rrezikshme e të dëmshme, parkimi i mjeteve para ose pranë pikave të mësipërme, mospastrimi i hapësirave publike dhe terreneve private, hedhja në territore dhe sipërfaqe publike e mbeturinave të përcaktuara në nenin 5, mospastrimi i vendeve përreth lokaleve ose pikave ambulante të shitjes, dënohen me gjobë nga 1000 lekë deri në 5000 lekë.

Gjobat vendosen nga inspektorët sanitarë të caktuar nga bashkia ose komuna.

KREU VIII
ANKIMET

Neni 38
Ankimi

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankimi, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, te kryetari i bashkisë ose komunës.

KREU IX
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 39

Ngarkohet Ministria e Ndërtimit dhe e Turizmit së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit dhe sekretari i Shtetit për Pushtetin Lokal të nxjerrin aktet nënligjore dhe rregulloren për largimin publik të mbeturinave.

Neni 40

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1448, datë 5.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha